



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	05.09.2016
Referencë:	
Nga:	Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Lënda:	Raporti i muajit Gusht 2016

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Gusht 2016, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Gusht				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
34	22		4	8

- Janë dhënë Përgjigje, Vendime, Pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet, dhe barazimi me të hyrat nga hapësirat publike.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit – pastrimi veror
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve në qytetin e Lipjanit.
- Janë bërë kërkesa për zotim të mjeteve: Pastrimi veror i rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit, vendosja e shenjave vertikale komunikacionit, modifikimi i kontejnerëve nëntokësor, blerja e kioskat, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Rubovc, kanalizimi në Blinajë, ndërtimi i lapidarëve në Kraishtë dhe Ribar i Madh, asfaltimi i rrugicave në Topiqan, asfaltimi i rr. Shalë – Bainsë, ndërtimi i rrugicave me kubëza në Janjevë, ndërtimi i shtratit të lumit në Banullë, asfaltimi i rrugës Blinajë.
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave për: mirëmbajtja e ndriçimit publik, asfaltimi i rrugës në Medvec te komunitetit RAE.
- Vizita në teren për përgatitjen e paramasave dhe parallogarite sipas kërkesave të drejtorateve dhe palëve.
- Janë bërë sanime të rrugëve të asfaltuara në disa rrugë të qytetit të Lipjanit.
- Është bërë largimi i katër pengesave në rrugën e fshatit Shalë me kompaninë KRM Pastrimi
- Vizita në teren për zhblokim të rrjeteve të kanalizimit në: Babush, Gadime në qytetin e Lipjanit, Kroimir dhe në Bujari.
- Pëlqim Bechtel Enka për devijim të rrugës në hyrje të fshatit Smallushë me rastin e punimeve në autostradë.
- Janë dhënë Vendime për shfrytëzim të hapësirës publike
- Marrja pjesë në hapje dhe në vlerësim të ofertave tenderuese për projektet e infrastrukturës.
- Raporte Drejtorisë së Prokurimit për realizimin e punimeve sipas kontratave

- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugëve në fshatin Gllgovc, është bërë pranimi teknik,
- Mbikëqyrja e asfaltimit të rrugës në fshatin Magurë, është bërë pranimi teknik
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në Magurë punimet kanë përfunduar, pritet pranimi teknik
- Mbikëqyrja e asfaltimit të rrugës Banullë – Gllgovc, është bërë pranimi teknik.
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në Rufc të Vjetër është bërë pranimi teknik
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në Gllgovc, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në fshatin Banullë, punimet vazhdojnë
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në Ribar i Madh, punimet kanë përfunduar dhe pritet pranimi teknik
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në Ribar i Vogël, punimet vazhdojnë
- Mbikëqyrja e ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në fsh. Mirenë, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Mbikëqyrja asfaltimi i rrugëve Medvec, është bërë pranimi teknik .
- Mbikëqyrja në ndërtimin e kanalizimit në fshatin Rubovc, punimet vazhdojnë
- Mbikëqyrja e asfaltimit të rrugës në fshatin Magurë – Qylagë - Dobrajë e Madhe, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik.
- Mbikëqyrja e punimeve, ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Gadime, punimet janë duke vazhduar
- Mbikëqyrja e punimeve, ndërtimi i fushave të vogla sportive: Kraishtë, Ribar i Madh, Gllgovc dhe në SHFMU "Ismail Luma" Lipjan është bërë pranimi teknik.
- Mbikëqyrja e punimeve, ndërtimi i trotuareve në fshatin Llugaxhi, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Mbikëqyrja e punimeve mirëmbajtja e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit.
- Mbikëqyrja e punimeve, pastrimi dhe hapja e lumit Sitnica, punimet janë duke vazhduar
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, Vendime, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	24
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	5
3	Përgatitja e paramasave dhe parallogarive	
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
7	Vizita në terren	96
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	2
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	1